

## RREGULLORE E BRENDSHME

### 2021-024 Për funksionimin e njësisë bazë të Qendrës Kërkimore-Shkencore dhe publikimeve akademike të Akademisë “Nehemiah Gateway”

#### Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe detyrimet e njësive kompetente, pjesëmarrësve të veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe veprimtaria publikuese në kuadër të kërkimit shkencor të Akademisë “Nehemiah Gateway”.

#### Neni 2 Bazat ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është në përputhje me ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Statutin e Akademisë “Nehemiah Gateway” Neni 15 dhe Neni 75 (Aprovuar me Vendim Nr.1 datë 26.09.2019 të Senatit Akademik dhe Vendim Nr. 297 datë 23.11.2019 të Bordit të Administrimit.

#### Neni 3 Parimet

Kërkimi shkencor dhe veprimtaritë e kërkimit shkencor pranë Akademisë “Nehemiah Gateway” bazohen në parimet themelore të integritetit të kërkimit shkencor. Duke nxitur kërkuesit që të hulumtojnë në pajtueshmëri me sfidat bashkëkohore, duke ruajtur dhe promovuar etikën profesionale dhe intelektuale, si edhe duke nxitur mendimin kritik, analizën dhe kërkimin shkencor te stafi akademik dhe studentët.

1. **Parimi i Autenticitetit** për origjinalitetin e punimeve dhe krijimin në bazë të shfrytëzimit të kapacitetit personal intelektual, si edhe në zbatim rigoroz të ndjekjes së kriterëve për metodologjinë e kërkimit dhe hulumtimit shkencor, analizën, sistemin e referencave dhe përdorimin e burimeve.
2. **Parimi i Përgjegjshmërisë** për ndjekjen e kërkimeve që në fazën e tyre fillestare me propozimin e tematikës, mentorimi gjatë zhvillimit (në rastin e studentëve), lehtësimi i procedurës për mbullimin e shpenzimeve (në zbatim Fondi i Kërkimit Shkencor) dhe deri te publikimi dhe promovimi i gjetjeve të punimit/kërkimit në veçanti, ose tërësi. Duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave të përpunuara apo gjetjeve, në rastet kur këto kërkohen sipas parashikimeve ligjore.
3. **Parimi i Paanshmërisë** gjatë kërkimit shkencor dhe veprimtarisë shkencore; për trajtimin e paanshëm dhe në bazë të meritokracisë për pranimin e temave të propozuara dhe hulumtimit; për ofrimin e shanseve të barabarta gjatë mundësive për përfshirje në ekipet e kërkimit gjatë veprimtarive shkencore të organizuara nga Akademia “Nehemiah Gateway”, me/për të tretët.
4. **Parimi i Qëndrueshmërisë, zhvillimit dhe transparencës** për organizimin, ndarjen e punëve sipas kualifikimeve dhe aprovimin e kërkimeve duke favorizuar propozimet që janë në pajtueshmëri me Axfordën Kërkimore-Shkencore dhe publikimi i tyre, pasi të jenë miratuar nga Qendra Kërkimore-Shkencore.

#### **Neni 4**

#### **Aktivitetet kërkimore-shkencore**

Veprimtaria kërkimore-shkencore e Akademisë “Nehemiah Gateway” propozohet nga Fakulteti dhe miratohet nga Qendra Kërkimore-Shkencore; është e orientuar në nevojat e komunitetit, kryesisht ku ka selinë IAL-ja, duke marrë në konsideratë edhe nxitjen e kërkimit shkencor të stafi akademik dhe studentët, por pa përjashtuar edhe angazhimin dhe bashkëpunimin me partnerë dhe universitete homologe në vend dhe disa IAL në rajon dhe më gjerë.

Ndër veprimtaritë dhe aktivitetet kryesore janë:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me kompani dhe institucione në kuadër të sistemit dual të studimit ku studenti i programit BA kryen praktikën mësimore 50% të kohës së programit të studimit, duke arritur objektivat e moduleve të praktikës në fushat e programit të akredituar.

2. Marrëveshje kuadër bashkëpunimi me disa Institucione të Arsimit të Lartë në Shqipëri, por dhe jashtë saj, në kuadër të shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve ndërkombëtarë;
3. Organizimi i konferencave ndërkombëtare periodike në rang studentor në bashkëpunim me IAL dhe OJF që operojnë brenda dhe jashtë vendit;
4. Organizimi i konferencave ndërkombëtare periodike në rang universitar në bashkëpunim me IAL, publike dhe private, që operojnë brenda dhe jashtë vendit;
5. Veprimtari publikuese në revista shkencore, si njësi, nëpërmjet stafit akademik dhe të njëjtët, si pjesë e bordit/eve shkencor/e;
6. Realizimi i kërkimeve shkencore në: Vlerësimin e Nevojave të Komunitetit, pjesë e Axfordës Kërkimore-Shkencore së Akademisë “Nehemiah Gateway”, e miratuar;
7. Veprimtari të tjera kërkimore - shkencore në fusha që mbuloohen nga programet e studimit të Akademisë “Nehemiah Gateway”. Udhëtime studimore në kuadër të studimeve, duke përzgjedhur destinacionin sipas kalendarit të propozuar nga pedagogët udhëheqës së lëndëve dhe të miratuar nga Fakulteti dhe Qendra Kërkimore-Shkencore.

## **Neni 5**

### **Kërkimi shkencor dhe interesi komunitar**

Kërkimet shkencore pranë Akademisë “Nehemiah Gateway” realizohen në fusha që lidhen drejtpërdrejt me nevojat e komunitetit.

1. **Përfitues** së këtyre hulumtimeve janë stafi akademik i fakultetit dhe departamentit, anëtarët apo të angazhuarit pranë Qendrës Kërkimore-Shkencore, duke përfshirë studentët e diplomuar ose në proces diplomimi.
2. **Veprimtaritë shkencore dhe kërkimi shkencor** zhvillohen në pajtueshmëri të plotë me Axfordën Kërkimore-Shkencore, e cila është e orientuar mbi elaborimin dhe studimin e çështjeve që prekin komunitetin dhe ofrojnë zgjidhjet e duhura dhe implementimin e praktikave më të suksesshme.
3. **Hulumtuesit** që aplikojnë pranë Qendrës Kërkimore-Shkencore, si staf i brendshëm, të ftuar apo studentë, operojnë duke identifikuar nevojat më urgjente të strukturave lokale, duke përcaktuar qasjet strategjike për përmirësim dhe zhvillimin e planeve përmirësuese në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit.

4. **Bashkëpunëtorët (e jashtëm)** në bashkëpunimet kërkimore bien dakord për pritshmëritë, standardet shkencore dhe integritetin kërkimor; për ligjet, rregulloret dhe aktet normative ndërinstitucionale që do të zbatohen, të cilat sanksionojnë dhe sigurojnë gjatë bashkëpunimeve mbrojtjen e së drejtës së autorit për bashkëpunëtorët dhe mbi procedurat për të trajtuar konfliktet apo rastet të mundshme që mund të shkaktojnë vepra penale/ penalitete sipas legjislacionit në fuqi.
5. **Punimet** (artikujt shkencorë të botuara në revista shkencore, literatura shkencore universitare, broshura të konferencave etj.) që ndiqen, vlerësohen dhe mentorohen nga Qendra Kërkimore-Shkencore e Akademisë “Nehemiah Gateway”, publikohen me logon e Akademisë “Nehemiah Gateway” dhe me emrin e autorëve (apo bashkautorëve) të punimit/kërkimit shkencor apo librit përkatës, më pas regjistrohen dhe janë pjesë e fondit të librisë së Akademisë “Nehemiah Gateway”.

## **Neni 6**

### **Procedura dhe realizimi i kërkimeve shkencore dhe publikimeve**

Akademia “Nehemiah Gateway” realizon aktivitete dhe projekte kërkimore bazë dhe të aplikuara në përputhje me qëllimet dhe objektivat e institucionit. Këto janë të parashikuara në Axhendën Kërkimore-Shkencore të Akademisë “Nehemiah Gateway”, e cila hartohet nga Qendra Kërkimore-Shkencore dhe propozohet te Senati Akademik nga Rektori.

Axhenda Kërkimore-Shkencore bazohet në Planin e Zhvillimit Strategjik të Institucionit, i cili propozohet nga Rektori dhe më pas aprovohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.

Senati Akademik vlerëson çdo vit aktivitetet kërkimore të IAL-së, nëse mjedisi i kërkimit nuk dikton emergjenca që duhen marrë në konsideratë (si rasti i pandemisë) dhe më pas i bën propozime Rektorit për Axhendën Kërkimore-Shkencore të vitit vijues.

Qendra Kërkimore-Shkencore për Publikimet dhe Botimet ndjek dhe kujdeset mbi zbatimin e procedurës së parashikuar sipas Nenit 5.

## **Neni 7**

### **Qendra Kërkimore-Shkencore**

1. Qendra Kërkimore-Shkencore është njësi bazë nën Fakultetin, e cila kryen aktivitete kërkimore-shkencore dhe të zhvillimit të arsimit në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik të Akademisë “Nehemiah Gateway”.
2. Ajo përfshihet në dizejimin, monitorimin dhe implementimin e projekteve kërkimore dhe ndërmerr kërkime të vetat ose në bashkëpunim me institucione të tjera brenda ose jashtë vendit.
3. Qendra Kërkimore-Shkencore mbështet realizimin e programeve të studimit “Bachelor” “Master Shkencor”, të cilat ofrohen nga departamentet e Fakultetit të Akademisë “Nehemiah Gateway”.
4. Qendra Kërkimore-Shkencore përfshin në ekipin e punës kërkimore të gjithë personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm, si dhe kërkuesit shkencorë të ftuar.
5. Qendra Kërkimore-Shkencore mund të ofrojë shërbime për palët e treta, si dhe të zhvillojë dhe organizojë aktivitete të tjera, në përputhje me Ligjin, Statutin e Akademisë “Nehemiah Gateway”, si dhe aktet e tjera të brendshme normative të Akademisë “Nehemiah Gateway”, në përputhje me Nenin 5 të kësaj Rregulloreje, shërbimet e tjera akademike duhet të rivlerësohen nga njësi bazë dhe më pas të përfshihen në listën e aktiviteteve.
6. Qendra Kërkimore-Shkencore monitoron dhe sugjeron mbi zbatimin e politikave institucionale, sistemeve, procedurave, strategjive dhe burimeve për menaxhimin e cilësisë së funksioneve thelbësorë të mësimdhënies, nxënies dhe kërkimit shkencor, monitorimin e efektivitetit të sistemeve të menaxhimit të cilësisë së akademisë dhe promovimin e një kulture për përmirësim të vazhdueshëm brenda tij.
7. Qendra Kërkimore-Shkencore vepron si organ konsultativ për shqyrtimet mbarë institucionale të kryera nga Bordi i Administrimit, autoritetet shtetërore ose organet e akreditimit.
8. Qendra Kërkimore-Shkencore promovon zhvillimin e risive të lidhura me përmirësimin e cilësisë dhe standardit shkencor të kërkimeve në nivel studentor dhe të stafit akademik, duke siguruar praktikën dhe kulturën mbizotëruese të integritetit kërkimor.
9. Qendra Kërkimore-Shkencore këshillon Rektoratin në lidhje me çështjet që përputhen me kërkesat kombëtare dhe institucionale për sigurinë e cilësisë dhe bën rekomandimet e duhura në lidhje me çështjet që kërkojnë vëmendje, të cilat vlejné të përfshihen në Axhendën Kërkimore-Shkencore.

10. Qendra Kërkimore-Shkencore promovon përhapjen e praktikave më të mira, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e mjedisit kërkimor shkencor; realizimin e sesioneve trajnuese dhe kualifikuese për stafin e qendrës dhe hulumtuesit; procedurat për kërkimin shkencor; mbrojtjen e krijimtarisë dhe autorësisë, apo bashkëautorësisë; mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave; punën e përbashkët apo bashkëpunimet në kërkimet shkencore; publikimet dhe botimet, nën logon e Akademisë “Nehemiah Gateway” ose në bashkëpunim; konsulenca e raporteve të praktikës mësimore dhe sugjerimi për përmirësim e tyre; këshillimin e studentëve (individualisht dhe në grup) për atributet e kërkimit shkencor dhe realizimin e veprimtarive shkencore.
11. Qendra Kërkimore-Shkencore siguron këshillim për komisionet dhe strukturat e duhura në lidhje me promovimin e kërkimit shkencor dhe publikimeve, në funksion të progresit intelektual dhe profesional të stafit akademik dhe studentëve.
12. Qendra Kërkimore-Shkencore raporton pranë Rektoratit të Akademisë “Nehemiah Gateway”, për mënyrën e përdorimit të fondeve dhe harton raportin e arritjeve duke evidentuar edhe natyrën e shpenzimeve dhe ezaurimin e planit financiar të buxhetuar të Qendrës Kërkimore-Shkencore.
13. Qendra Kërkimore-Shkencore mund të ketë kompetenca të tjera që rregullohen nga statute, rregullorja dhe aktet e brendshme normative të Akademisë “Nehemiah Gateway”.

## **Neni 8**

### **Infrastruktura që mbështet dhe mbron kërkimin shkencor**

Akademia “Nehemiah Gateway” ofron një infrastrukturë të pajisur mirë dhe të përshtatshme për institucionin në madhësinë e saj aktuale. Sallat janë të pajisura me mjete teknike, si: wireless dhe LAN, dërrasa të bardha, projektor dhe pajisje Smart Bord, si dhe sistem transmetimi wireless.

Akademia “Nehemiah Gateway” ofron hapësira dhe pajisje të mjaftueshme pune për të përmbushur detyrat e tyre dhe për të kryer aktivitete hulumtuese ku vlen të përmendet një laborator kompjuterik në dispozicion të stafit akademik, studentëve.

Akademia “Nehemiah Gateway” gëzon personelin, njësitë dhe infrastrukturën e duhur për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit, shoqëruar me akte të brendshme rregulluese mbi arkivimin, përdorimin, përpunimin dhe qarkullimin e tyre, në rrjet të brendshëm elektronik, të pajisur me elementë të lartë sigurie dhe nën përgjegjësinë e monitorimit nga Departamenti i MAR (marketing) me personel përgjegjës të posaçëm.

Blioteka e institucionit është një komponent vital në mbështetjen e aktiviteteve kërkimore të studentëve dhe hulumtuesve shkencorë, Akademia “Nehemiah Gateway” ofron një sërë shërbimesh. Biblioteka është e mirëpajisur me koleksione librash të printuar, të cilat janë në dispozicion të përdoruesve si edhe digjitalë, që Akademia “Nehemiah Gateway” i ofron nëpërmjet abonimit me disa revista shkencore elektronike.

Akademia “Nehemiah Gateway” mbështet kërkimin shkencor dhe me burime online literature si: jstore, <https://www.cceol.com>.

## **Neni 9** **Zhvillimi i Planit Strategjik**

1. Veprimtaritë kërkimore-shkencore për programet dhe projektet e miratuara nga Senati Akademik, realizohen mbi bazën e zhvillimit të Planit Strategjik të Institucionit dhe Axhendës Kërkimore-Shkencore të Qendrës Kërkimore-Shkencore.
2. Punimet e diplomës në nivelin Bachelor dhe ato në nivel Master konsiderohen punime shkencore dhe i nënshtrohen planifikimit shkencor.
3. Të gjitha kërkimet e realizuara, dhe në proces brenda IAL-së, si edhe ato me/për të tretët, janë pjesë e Axhendës Kërkimore-Shkencore dhe të hapura për t'u përzgjedhur nga studentët dhe stafi akademik mentorues dhe mbikëqyrës.

## **Neni 10** **Financimi i Kërkimit Shkencor**

Veprimtaria kërkimore-shkencore financohet kryesisht nga buxheti i Akademisë “Nehemiah Gateway” për kërkime shkencore, por dhe nga donatorë të jashtëm, kur Akademia “Nehemiah Gateway” është palë në marrëveshje bashkëpunimi për projekte kërkimore-shkencore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si edhe aktet e brendshme rregulluese.

Plani buxhetor me të cilin mbështetet kërkimi-shkencor është në funksion të realizimit të Planit Strategjik dhe në zbatim të Axhendës Kërkimore-Shkencore të Akademisë “Nehemiah Gateway”. Plani Strategjik i aktualizuar ndërtohet mbi 6 shtylla kryesore, të cilat janë:

1. Qëndrueshmëria i programeve të ofruara të studimit, duke rritur cilësinë e kurrikulës dhe mësimdhënies;
2. Stabilizimi i programeve të trajnimeve profesionale dhe kualifikimeve të mëtejshme;
3. Rritja e numrit të studentëve të regjistruar në programet akademike;
4. Qëndrueshmëria financiare e Akademisë “Nehemiah Gateway”, nëpërmjet rritjes së të ardhurave dhe optimizimit të shpenzimeve, për të rritur efektivitetin e fondeve të shpenzuara;
5. Nxitja e Kërkimit Shkencor dhe realizimi i plotësimit të Axhendës Kërkimore-Shkencore nëpërmjet projekteve kërkimore, lokale dhe rajonale, të cilat orientohen drejt nevojave të komunitetit.
6. Sigurimi i mëtejshëm i cilësisë së brendshme dhe akreditimit të programeve akademike dhe atij institucional.

Plani buxhetor miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Akademisë “Nehemiah Gateway”. Ky plan buxhetor parashikon ruajtjen e qëndrueshmërisë së përgjithshme të Akademisë “Nehemiah Gateway”.

Financimi i hulumtuesve, ekipeve dhe në rastet e bashkëpunimit realizohet sipas procedurave dhe kriterëve të miratuara në Fondin e Kërkimit Shkencor, dokument i aprovuar dhe publikuar online (<https://www.ng-university.org/al/kerkimi/fondi-i-kerkimit-shkencor>).

Ndërsa, transparenca e shpenzimeve dhe përfitimit të financimeve reflektohet tek Raporti mbi mënyrën e përdorimit të fondeve në Akademinë “Nehemiah Gateway”, i hartuar nga Departamenti i Financave dhe publikohet online (<https://www.ng-university.org/al/rreth-nesh/perdorimi-i-fondeve>).

## **Neni 11** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik dhe nënshkrimit nga Kryetari i Senatit Akademik.

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje informohet Qendra Kërkimore-Shkencore.

Sipas Statutit të Akademisë “Nehemiah Gateway”, Rregullorja është publikuar në Manualin e brendshëm të Akademisë “Nehemiah Gateway”.